

**STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE
ME OFERTË PRIVATE
“ABEL ENERGY ALBANIA” SHA**


Aksionarët e mëposhtëm:

1. *Shoqeria “B93 II”* sh.p.k., me nr. NIPT-I **L522090500**, perfaqesuar nga administratori i shoqërisë, **Z.Ardit Liçaj**, atesia Shpetim, i datelindjes 05.03.1990, lindur ne Ballsh, i pajisur me leternjoftime numer personal **J00305109G** shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar
2. *Shoqeria “Shendelli”* sh.p.k., me nr. NIPT-i **K07924803N**, perfaqesuar nga administratori i shoqërisë, **Z.Yzedin Bozhaj**, datelindjes 20.01.1960, lindur ne Fier, i pajisur me leternjoftime numer personal **G00120183L** shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar.
3. Aurel Byberi, datelindjes 28.01.1985, lindur ne Bajram Curri, i njohur prej meje noteres, i pajisur me leternjoftime numer personal **I50128082V**, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar,
4. Akil Doçi, shtetas shqiptar, i biri i Ibish, lindur me 04.02.1986 ne Bajram Curri, Tropoje e banues ne Durres, mbajtes i leternjoftimit me nr. 032523340 dhe nr. personal I60204078P, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar

duke u bazuar në Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjin Nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” dhe Aktin e Themelimit, vendosën të miratojnë statutin e shoqërisë tregtare me ofertë private “**ABEL ENERGY ALBANIA sh.a**”, si më poshtë vijon:

**NENI 1
EMRI**

1. Emri i shoqërisë është “**ABEL ENERGY ALBANIA**” SHA
2. Emri i shoqërisë do të ndiqet nga prapashtesa “SHA”, e cila përcakton formën e organizimit si shoqëri aksionare.



NENI 2 FORMA LIGJORE

1. Shoqëria është një shoqëri aksionare me ofertë private.
2. Shoqëria vepron në përputhje me këtë statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.
3. Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me parashikimet e nenit 228 dhe vijues të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 3 AKSIONARËT E SHOQËRISË

1. Shoqëria "ABEL ENERGY ALBANIA" SHA është themeluar prej Aksionarëve të mëposhtëm:
 - A. Shoqëria "B93 II" sh.p.k., zotëron 1000 (njëmijë) aksione, me vlerë 1.000.000 (një milion lekë) Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 1.000 (një mijë) lekë dhe që në përqindje 20% (njetzetë) të aksioneve.
 - B. Shoqëria "Shendelli" sh.p.k zotëron 1000 (njëmijë) aksione, me vlerë 1.000.000 (një milion lekë) Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 1.000 (një mijë) lekë dhe që në përqindje 20% (njetzetë) të aksioneve.
 - C. Aurel Byberi , zotëron 2000 (dymijë) aksione, me vlerë 2.000.000 (dy milion lekë) Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 1.000 (një mijë) lekë dhe që në përqindje 40% (dyzetë) të aksioneve.
 - D. Akil Doçi zotëron zotëron 1000 (njëmijë) aksione, me vlerë 1.000.000 (një milion lekë) Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 1.000 (një mijë) lekë dhe që në përqindje 20% (njetzetë) të aksioneve.

NENI 4 SELIA

1. Shoqëria ka selinë e saj në adresën:
"Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga "Ismail Qemali,Pallati Nr.3/162, Kati 4-t, Ap.10
Asambleja e ortakëve mund t'a ndryshojë lirisht adresën e Selisë së shoqërisë.
2. Shoqëria tregtare "ABEL ENERGY ALBANIA" SHA me regjistrimin e këtij statuti pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pas regjistrimit të saj si person juridik, mund të marrë masa për të patur një adresë interneti si dhe një postë

elektronike për komunikim. Këto adresa do të jenë të vlefshme për të tretët vetëm pasi t'i jenë njoftuar Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me pikën 2 të nenit 69 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

1. Shoqëria tregtare "ABEL ENERGY ALBANIA" SHA ka si objekt te veprimtarisë se saj:

Investime dhe shërbime në fushën e prodhimit te energjise elektrike, shitjes, ndertim HEC, dhe cdo veprimtari e lidhur me të, ndertim, projektim, rikonstruksion ndertime civile, ekonomike, industriale dhe turistike, Ndertime rrugësh, vepra hidroteknike etj. Prodhim e tregtim te energjisë elektrike, materialeve te ndertimit, Tregtim makinerie e pjese kembimit per llojet e ndryshme te makinerive në funksion te veprimtarisë së saj, si dhe import-eksportin e tyre.. Perfaqesim Brandi te huaj- Zhvillimi rrjeti shitjeje si dhe shitje nepermjet internetit(online). Hoteleri turizem dhe gjithçka te lidhur me kete fushe me qellim krijimin e kushteve te favorshme per ecurin e biznesit edhe pas themelimit edhe pse nuk jan parashikuar specifikisht ne statut. Shoqeria ka per objekt import-eksportin, prodhimin, industrializimin dhe tregtimin e te gjitha produkteve te deshuruara qe nuk bien ndesh me asnje.

Ligj, qofte drejtperdrejt ose permes paleve te treta, kryesisht mallra e produkte te nevojshme per kryerjen aktivitetit ekonomik e permbushjen e objektivave. Si pjese e aktivitetit te saj shoqeria mund te financoje pale te treta, ose mund te marre financime dhe te kryej ndermjetesime dhe brokerime te cdo lloji, ne nivel nderkombetar. Bashkpunimi me kompani e subjekte te te njejtës fushe si dhe ndermjetesime konsulenca per vendosjen e shoqerive te huaja ne Shqiperi.

2. Objekti i aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe këtë Statut.



NENI 6 KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË





1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është për një afat të pacaktuar.
2. Ky afat mund të ndryshohet me vendim të Aksionarëve me kërkesë drejtuar Këshillit Mbikqyrës, sipas rregullave të parashikuara në këtë statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 7 KAPITALI DHE AKSIONET

- Kapitali është i ndarë në 5000 (pesë mijë) aksione të zakonshme me vlerë nominale 1.000 (një mijë) Lekë secili.
Pjesëmarrja e aksionarëve vetëm në kapitalin themeltar të shoqërisë është:
 - A. Shoqëria "B93 II" sh.p.k., zotëron 1000 (njëmijë) aksione, me vlere 1.000.000 (një milion lekë) Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 1.000 (një mijë) lekë dhe që në përqindje 20% (njezetë) të aksioneve.
 - B. Shoqëria "Shendelli" sh.p.k zotëron 1000 (njëmijë) aksione, me vlere 1.000.000 (një milion lekë) Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 1.000 (një mijë) lekë dhe që në përqindje 20% (njezetë) të aksioneve.
 - C. Aurel Byberi , zotëron 2000 (dymijë) aksione, me vlere 2.000.000 (dy milion lekë) Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 1.000 (një mijë) lekë dhe që në përqindje 40% (dyzetë) të aksioneve.
 - D. Akil Doçi zotëron zotëron 1000 (njëmijë) aksione, me vlere 1.000.000 (një milion lekë) Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 1.000 (një mijë) lekë dhe që në përqindje 20% (njezetë) të aksioneve.
- Secili aksion është nënshkruar dhe do të shlyhet nga aksionarët përkatës.

NENI 8 TRANSFERIMI I AKSIONEVE

1. Aksionet mund të zotërohen nëpërmjet blerjes, trashëgimisë, dhurimit dhe ndonjë mënyre tjetër të pranuar nga ligji.

_____ Faqe4 _____

2. Aksionaret të cilët vendosin të shesin kuotat e tyre pjesërisht apo tërësisht detyrimisht do duhet t'ja ofrojnë fillimisht atë aksionarëve të tjerë të kësaj shoqërie dhe Transferimi i aksioneve tek të tretët është i kushtëzuar nga e drejta e parablerjes me të njëjtat kushte, e drejtë e cila duhet të ushtrohet brenda 2 (dy) muajsh nga marrja e njoftimit të drejtuar aksionarëve të kësaj shoqërie, me postë rekomande, me vërtetim marrje, mbi shitjen e dëshiruar dhe kushtet e paraqitura. Mosrespektimi i kësaj dispozite e bën shitjen të pavlefshme.
Çdo vendim për shitjen e aksioneve do duhet të marrë miratim paraprak dhe pëlqimin nga të gjithë anëratët e Këshillit Mbikqyrës dhe asamblesë së aksionarëve.
3. Çdo transferim i aksioneve duhet të regjistrohet në regjistrin e aksioneve të shoqërisë dhe në Regjistrin Tregtar Shqiptar, në përputhje me nenin 119 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" përndryshe, mbajtësi i aksionit nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e përcaktuara në këtë statut dhe ligjin shqiptar.
4. Në rastet e kalimit të aksioneve me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi aksionet, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata.
5. Kontrata për kalimin e aksioneve hartohet në formë shkresore dhe noterizimi përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës.
6. Në raste fatkeqësie kur një nga aksioneret ndërron jete të drejtat dhe detyrimet i kalojnë në baze të përçindjes takuese familjarve të tyre në rastin e aksionareve individuale, ndërsa në rastin kur aksionaret janë shoqëri të regjistruara për të zbatohet ligji për shoqëritë tregtare.

NENI 9 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

1. Asambleja e Ortakëve vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë duke marrë miratimin e Këshillit Mbikqyrës.
2. Asambleja e Ortakëve vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit në mënyrë unanime.
3. Mënyrat dhe procedurat përkatëse të rritjes dhe zvogëlimit të kapitalit do të vendosen dhe kushtëzohen në përputhje me nenet 168-186 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", por gjithmonë duke mbajtur shumicës së cilësuar të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.



NENI 10
ANULIMI I AKSIONEVE

Asambleja e Ortakëve përsëri në mënyrë unanime mund të marrë vendimin mbi anulimin e aksioneve qoftë dhe të atyre që zotëron njëri aksionar. Në këtë rast do të ndiqen dispozitat dhe kërkesat e zvogëlimit të kapitalit.

NENI 11
ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organet e shoqërisë janë:
 - a) Asambleja e Ortakëve, në cilësinë e organit vendimmarrës për shoqërinë;
 - b) Këshilli Mbikëqyrës;
 - c) Administratori i shoqërisë.

2. Asambleja e Ortakëve, ka të drejtë të caktojë dhe ose/krijojë, bazuar në propozimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe/ose Administratorit/Administratorëve, organe/struktura teknike brenda shoqërisë.

NENI 12
ASAMBLEJA E ORTAKËVE NË CILËSINË E ORGANIT VENDIMMARRËS

1. Asambleja e Ortakëve, është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakëve ushtron kompetencat e mëposhtme dhe vendos në mënyrë unanime të votave për të gjithë aksionarët e shoqërisë për:
 - a. *përcaktimin e politikave tregtare;*
 - b. *ndryshime të statutit;*
 - c. *emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës;*
 - d. *të emërojë dhe shkarkojë administratorin*
 - e. *emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar (audituesit ligjor);*
 - f. *miratimin e skemës së shpërblimeve për anëtarët e këshillit mbikëqyrës, administratorët, ekspertët kontabël dhe likuiduesve;*
 - g. *miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;*
 - h. *shpërndarjen e fitimeve vjetore;*
 - i. *zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;*




- j. pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - k. ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - l. përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
 - m. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - n. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - o. çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti, që i njihen Asamblesë së Ortakëve si organ vendimmarrës i shoqërisë.
3. Asambleja e Përgjithshme, për çështjet parashikuara në shkronjën (e) dhe (f), do të vendosë pasi të ketë marrë dokumentacionin përkatës së bashku me raportin e Këshillit Mbikëqyrës dhe ekspertit kontabël (audituesit ligjor).
 4. Anëtarët e parë të Këshillit Mbikëqyrës emërohen drejtpërdrejt nga Asambleja e Përgjithshme.
 5. Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
 6. Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në përputhje me legjislacionin shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendit ku personi juridik ka qendrën e vet.
 7. Shoqëria ka vulën e saj dhe logon e saj. Forma dhe përmbajtja e vulës mund të ndryshohen me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme, vula e shoqërisë dhe logoja mund t'i raportohen Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 13 THIRRJA E MBLEDHJES

1. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, si rregull thirret nga Administratori . Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës kanë të drejtë të thërrasin Asamblesë së Përgjithshme, sikurse është përcaktuar në Ligjin Shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
2. Eksperti Kontabël i Regjistruar (Audituesi Ligjor) ka të drejtë të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, vetëm për çështje financiare për të cilat është caktuar nga kjo e fundit.
3. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet t'i njoftohet të gjithë aksionarëve të shoqërisë me shkrim nëpërmjet postës së regjistruar ose nëpërmjet postës elektronike të paktën 21 (njëzetë e një) ditë përpara datës së



Faqe7



mbledhjes së saj. Në rast se palët konfirmojnë takimin ata mund të mblidhen edhe me herët me një afat që dakordësojnë të gjithë.

4. Njoftimi duhet të përmbajë të gjithë elementët e përcaktuar në nenin 137 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
5. Edhe në rastin kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme nuk është thirrur në përputhje me këtë nen, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, pavarësisht parregullsisë me kusht të të gjithë aksionarët të jenë prezent. I njëjti përcaktim gjen zbatim edhe në rastin kur dispozitat që kanë lidhje me caktimin e vendit të mbledhjes dhe rendin e ditës së mbledhjes, nuk janë respektuar.

NENI 14 KËSHILLI MBIKËQYRËS

1. Këshilli Mbikëqyrës verifikon implementimin e politikave tregtare nga ana e Administratorëve si dhe përputhshmërinë e veprimeve të tyre me ligjin dhe këtë statut.
2. Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a. të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
 - b. të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
 - c. të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
 - d. të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
 - e. të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
 - f. të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit mbikëqyrës për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
 - g. të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur dhe se raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve.

3. Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të ushtrojë dhe kryejë çdo veprim tjetër të sanksionuar në Ligjin Shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe që nuk është parashikuar në këtë statut.

NENI 15

PËRBËRJA DHE VENDIMARRJA E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës caktohen nga aksionarët në përputhje me dispozitat e këtij statuti dhe të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Asambleja e Përgjithshme cakton një nga anëtarët si Kryetar të Këshillit Mbikëqyrës.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve, punëmarrësve të shoqërisë dhe/ose individëve të tjerë jashtë shoqërisë.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të jenë të ndryshëm nga Administratorët e shoqërisë.
4. Vendimet e këshillit mbikëqyrës vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimarrjeve janë të pranishëm më shumë se 4/5 e anëtarëve.
5. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, vendimet merren në mënyrë unanime.
6. Vendimet e këshillit mbikëqyrës mund të merren sipas përcaktimeve të statutit apo të rregulloreve të këshillit, duke shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i këshillit ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimarrjeje.

NENI 16

ANËTARËT E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

1. Anëtarët të Këshillit Mbikëqyrës emërohen:
 - Shpëtim Liçaj
 - Joana Bozhaj (Çuko)
 - Jehona Rexhaj
 - Eranda Byberi
 - Jehon Breçani
2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 3 (tre) vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Z. Shpëtim Liçaj , emërohet kryetar i Këshillit Mbikëqyrës, ndërsa pjesëtarët e tjerë janë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës. Mandati i Kryetarit përfundon në datën e përfundimit të mandatit të tij si anëtar.

NENI 17 ADMINISTRATORI

1. Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator me mandat 3 (tre) vjeçar. Administratori caktohet/emërohet nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë, në përputhje me dispozitat e statutit dhe ligjit shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Z.Albert Bozhaj.
2. Administratori i ka të drejtë të kryejë i vetëm të gjitha kompetencat që ky statut dhe ligji shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ia njuh administratorit të një shoqërie aksionare.

NENI 18 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

1. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:
 - a. të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të shoqërisë;
 - b. të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c. të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d. të përgatisë dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit mbikëqyrës për miratim;
 - e. të përgatisë propozime për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim në asamblenë e përgjithshme;
 - f. të kryejë kompetencat e parashikuara në ligj
2. Administratori mund të kryejnë edhe kompetenca të tjera të parashikuara nga ligji shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kompetenca të cilat nuk duhet të bien në kundërshtim me kompetencat që ky statut apo ligji i mësipërm ia njuh Këshillit Mbikëqyrës.
3. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
4. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë

administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme

5. Me regjistrimin e largimit të administratorit nga Qendra Kombëtare e Biznesit, regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", të ndryshuar, administratori i dorëhequr nuk mban përgjegjësi për veprimet e kryera nga ana e shoqërisë, apo personave të tjerë pas datës së regjistrimit të largimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
6. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar).

NENI 19 ADMINISTRATOR I SHOQËRISË

1. Asambleja e Përgjithëshme, ka vendosur që të emërojë z.**Albert Bozhaj**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e administratorit të kësaj shoqërie, me një mandat 3 (tre) vjeçar, mandat i cili fillon në datën që regjistrohet shoqëria pranë QKB, 25.05.2021 dhe përfundon në 25.05.2024 .
2. Administratori ka të drejtën e rizgjedhjes.

NENI 20 KUFIZIMI I KOMPETENCAVE TË ADMINISTRATORIT

1. Administratori, pa marrë më parë paraprakisht miratimin e Asamblesë së Ortakëve, nuk mund të tjetërsojë, në çfarëdo forme apo mënyre, apo të vendosë peng, hipotekë apo çfarëdo barre tjetër mbi pasuritë në pronësi të shoqërisë të llojit:
 - a. aksione apo kuota të një shoqërie bijë.
 - b. pasuri të paluajtshme.
2. Administratori, pa marrë më parë paraprakisht miratimin e Asamblesë së Ortakëve, nuk mund të nënshkruajë kontrata kredie apo të japë hua.

NENI 21 VITI FINANCIAR

Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 22
EKSPERTI KONTABËL I REGJISTRUAR
(AUDITUESI LIGJOR)

1. Aksionaret emërojnë ekspert kontabël të regjistruar (Auditues Ligjor). Ekspertët Kontabël të Regjistruar (Audituesit Ligjorë) kanë të drejtën e riemërimit. Ekspertë Kontabël i Regjistruar (Auditues Ligjorë) të Shoqërisë, për një afat 3 –vjeçar, me të drejtë riemërimi, caktohen:

- **Znj.Stoli Laze** me nr license 36 dt 13.01.2000, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- **Znj. Almarina Haxhi** me nr license 442 dt 06.02.2020, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Koment - Duhet te kete dy Auditues ligjor sipas ligjit per Auditimin





NENI 23
PASQYRAT FINANCIARE DHE KONTABILITETI

1. Pasqyrat financiare vjetore, përfshirë bilancin, dhe deklaratat do të përgatiten sipas legjislacionit shqiptar.
2. Në rast se legjislacioni i mësipërm e lejon, Administratori i shoqërisë mund të zgjedhë midis standardeve të ndryshme të kontabilitetit.

NENI 24
SHPËRNDARJA E DIVIDENDIT

1. Shoqëria do të deklarojë dhe shpërndajë tek Aksionaret si dividend, të gjithë fitimin e disponueshëm, pasi të jenë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe të rezervave të njohura nga legjislacioni në fuqi, si dhe pasi të jetë respektuar çdo marrëveshje tjetër mes aksionarëve mbi ripagesën e shumave të kredituar ose e investimeve të bëra në emër të shoqërisë.

NENI 25
HUAMARRJA/HUADHËNIA

  Faqe12  

1. Secili prej Aksionerëve në raport me pjesën takuese të % së tij, mund të aplikojë për huamarrje apo huadhënie vetëm për interesa të investimeve apo për nevoja të kësaj shoqërie, kundrejt bankave të nivelit të dyte, institucioneve kombetare/ndërkombëtare private apo shtetërore duke e lënë kolateral përqindjen e pjesës së tij takuese pa çenuar përqindjen e anëratëve/aksionerëve të tjerë të kësaj shoqërie.

Çdo huadhënie apo huamarrje do duhet të marrë miratimin nga të gjithë ortaket me unanimitet.

NENI 26 PRISHJA E SHOQËRISË

1. Shoqëria do të priset:

- a) Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me mbi 70% të votave;
- b) Me fillimin e procedurave të falimentimit/likuidimit;
- c) Me vendim të gjykatës kompetente;
- d) Në çdo rast tjetër dhe sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 27 LIKUIDIMI

1. Likuidimi i Shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 28 LIGJI I ZBATUESHËM

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 29



Faqe13



1. Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore.
2. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë;
3. Ky Statut hyn në fuqi, pas regjistrimit të tij së bashku me Vendimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme për miratimin e tij, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

AKSIONARËT THEMELUES

Aksioneri : Shoqeria "B93 II" sh.p.k. perfaqësuar nga Ardit Liçaj

Ardit Liçaj



Aksioneri : Shoqeria "Shendelli" sh.p.k perfaqësuar nga Yzedin Bozhaj

Yzedin Bozhaj



Aksioneri : Aurel Byberi

Aurel Byberi

Aksioner : Akil Doçi

AKIL DOÇI

Tirane me
25.05.2021